

MBI
AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË
DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR DURRËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në **Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Durrës**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor, Durrës”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 164, datë 26.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 733/6, datë 26.12.2013, i ka rekomanduar z. Tauland Baku, Drejtor i Shërbimit Spitalor Durrës, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Spitali Rajonal Durrës të njihet dhe përshtatë aktivitetin e vet në përputhje me parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*.
2. Spitali Rajonal Durrës të rishikojë dhe të reflektojë në *“Projektpreventivin e zbatimit të godinës së Pediatriisë”* zërat dhe volumet punimeve që janë kryer më parë, si dhe zërat e punimeve që janë përfshirë në preventiv prej OE *“X”* sh.p.k, por që nuk janë parashikuar në *“Detyrën e projektimit”*.
3. Për çdo rast të miratimit të pagave nga Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, të përcaktohen pagat për çdo punonjës, pasi të ketë dalë urdhri i brendshëm nga drejtori i Spitalit Rajonal Durrës.
4. Të merren masa që mandat arkëtimet e përdorura në pavijone, të bashkëlidhen me listën e personave që ju është shërbyer, mbi bazën e të cilëve të hartohet mandat arkëtimi përmbledhës, i cili pasqyron shumën e arkëtuar nga Spitali Rajonal Durrës, rrjedhojë e kësaj veprimtarie.
5. Spitalit Rajonal Durrës, të respektojë nivelin e shpenzimeve operative të përcaktuara me vendimet e Bordit Drejtues, i cili për periudhën e audituar rezulton me tejkalim rreth 5,600 mijë lekë.
6. Spitali Rajonal Durrës, për subjektet që lëshojnë faturat e thjeshta tatimore për shërbimet ose mallrat e ofruara, të marrë konfirmim për formën e tyre juridike në momentin e faturimit, me qëllim shmangien e efekteve negative fiskale.
7. Të grupojë blerjet dhe shërbimet e vogla, me qëllim eliminimin e copëzimit të fondeve dhe shmangien e procedurave të gabuara ligjore, duke realizuar përdorimin e fondeve publike me efektivitet dhe transparencë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **2,117,273 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

1. OE *“X”* SHA vlerën 1,399,288 lekë, e cila përfaqëson diferencën e ndryshimit të çmimit të karburantit në tenderët përkatës, në kundërshtim me pikën 2, të KREU VIII të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar dhe neneve të kontratës lidhur midis palëve.

2. OE "Y" sh.p.k. vlerën 386,812 lekë e cila përfaqëson punën e pakryer prej tij për "Projektpreventivin e Godinës së Infektivit", në kundërshtim me kushtet e fitimit të tenderit dhe kontratës lidhur midis palëve.
3. Zj. M.S. në vlerën 219,195 lekë, për shkak të llogaritjes të pasaktë të fondit limit në tenderin me objekt "Hartimi i projekt preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së pediatriisë".
4. Dy punonjësve të spitalit për vlerën 40,500 lekë, pasi janë shpërblyer pa qenë pjesëmarrës në mbledhjet e Bordit të Spitalit.
5. OE "X" sh.p.k. vlerën 58,878 lekë, të cilat përfaqësojnë penalitetet e ushtruara, pasi në tenderin me objekt "Blerje kite reagentë", nuk e ka realizuar plotësisht furniturën brenda afatit, në kundërshtim me nenin 3 të kontratës lidhur midis palëve.
6. Komisionit të prokurimit me vlera të vogla, pasi nga auditimi i tenderit "Shërbim për sistemin qendror të oksigjenit" të zhvilluar në vitin 2013 kanë skualifikuar padrejtësisht operatorin "X" sh.p.k. me ofertë më të ulët.

D. MASA DISIPLINORE

Në zbatim të nenit 72 pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu X, pika 3, mbështetur në kreu IV, neni 11, germa "e" dhe "ç" dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 "Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kontratën kolektive neni 18 dhe kontratën individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të Spitalit Rajonal Durrës, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

"Largim nga puna" për:

1. zj. M.A. me detyrë zv/drejtor ekonomik në cilësinë kryetarit të KVO, pasi në tenderët me objekt: "Blerje kite reagentë", "Riparim e mirëmbajtje lavatriçe industriale dhe tharëse industriale", "Blerje medikamente (51 lote)" të zhvilluar në vitin 2011, për lotin nr. 15 për "Blerje teicoplanin", dhe "Blerje programi i informatizimit të të gjitha të dhënave për Spitalin Rajonal Durrës, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreut V, pika 4/b, e, h si dhe DST "Kushtet e Veçanta të Kualifikimit".

2. zj. D.P. me detyrë juriste në njësinë e prokurimit, pasi në tenderët me objekt: "Blerje karburanti", "Blerje kancelari", "Blerje kite reagentë", "Shërbim catering" në vitin 2013 shtesë kontrate, "Shërbim catering" në vitin 2013, "Mirëmbajtje ashensori, gjeneratorë, kabine elektrike dhe blerje pjesë për kabinën e elektrike", "Riparim e mirëmbajtje lavatriçe industriale dhe tharëse industriale" dhe "Shërbimit të ruajtjes me roje private", fondi limit është përlllogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu II, pika 2/ç, 3/b dhe kreut IV pika 5/a, V, pika 2, germa a etj.

3. z. D.L. me detyrë anëtar i Komisionit të prokurimit, për blerjet me vlera të vogla, pasi në tenderët me objekt: "Shërbim për sistemin qendror të oksigjenit", "Blerje pompë drenazhi", "Blerje depozitë me tullumbace" dhe "Blerje depozitë me tullumbace", nuk ka mbajtur procesverbale, ka vendosur kushte shtesë në DST për kualifikimin e OE etj, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kreu VI, pika 2/c dhe Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.3.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla" pika 5, paragrafi dytë.

"Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna", për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

4. zj. SH.C. me detyrë anëtare e KVO,

5. zj. N.A. me detyrë anëtare e KVO,

Pasi në tenderin me objekt: "Blerje kite reagentë", "Riparim e mirëmbajtje lavatriçe industriale dhe tharëse industriale", "Blerje medikamente (51 lote)" të zhvilluar në vitin

2011, për lotin nr. 15 për “Blerje teicoplanin” dhe “Blerje programi i informatizimit të të gjitha të dhënave për Spitalin Rajonal Durrës kanë vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, kreut V, pika 4/b, e, h si dhe DST “Kushtet e Veçanta të Kualifikimit”.

Për anëtarët e Njesisë së Prokurimit:

6. zj. A.N. specialiste

7. zj. V.GJ. specialiste

Pasi në tenderët me objekt: “Blerje karburanti”, “Blerje kancelari”, “Blerje kite reagentë”, “Shërbim cateringu” në vitin 2013 shtesë kontrate, “Shërbim cateringu” në vitin 2013, “Mirëmbajtje ashensori, gjeneratorë, kabine elektrike dhe blerje pjesë për kabinën e elektrike”, “Riparim e mirëmbajtje lavatriçe industriale dhe tharëse industriale” dhe “Shërbimit të ruajtjes me roje private”, fondi limit është përlogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu II, pika 2/ç, 3/b dhe kreut IV pika 5/a, V, pika 2, germa a.

Për anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit me vlera të vogla

8. zj. M.XH. anëtare

9. zj. I.M. anëtare

Pasi si anëtare të Njesisë së Prokurimit në tenderët me objekt: “Blerje karburanti”, “Blerje kancelari”, “Blerje kite reagentë”, “Shërbim cateringu”, “Shërbim cateringu”, “Mirëmbajtje ashensori, gjeneratorë, kabine elektrike dhe blerje pjesë për kabinën e elektrike”, “Riparim e mirëmbajtje lavatriçe industriale dhe tharëse industriale” dhe “Shërbimit të ruajtjes me roje private”, nuk është miratuar kërkesa për prokurim, mungon urdhri për miratimin dhe ngritjen e komisionit të vlerësimit të fondit limit dhe specifikimeve teknike dhe nuk gjendet procesverbal për llogaritjen e tyre, vlerësimi i fondit limit është bërë nga njësia e prokurimit dhe jo nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla etj, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kreu II pika 2/b, ç, pika 3/b, kreut IV pika 5/a, dhe kreu V, pika 2/a, b.

Si anëtarë të Komisionit të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël në tenderët me objekt:

“Shërbim për sistemin qendror të oksigjenit”, “Blerje pompë drenazhi”, “Blerje depozitë me tullumbace” dhe “Blerje depozitë me tullumbace”, nuk kanë është mbajtur procesverbal për procedurën e zhvilluar, kanë vlerësuar dhe skualifikuar padrejtësisht ofertat e operatorëve ekonomikë etj, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu VI, pika 2/c dhe Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.3.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” pika 5, paragrafi dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Bexhet Zeqiri, Vasillaq Peci, Pwrparim Gjuzi, Odhise Veshi dhe Xhemal Luka, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT